



# Manuali për investitorët e huaj



# Manuali për investitorët e huaj

Sytrime Dervisholli  
Nora Hasani  
2020

Manuali  
për investitorët  
e huaj



Botues: Fondacioni-Konrad-Adenauer  
në Republikën e Kosovës

Autoret: Sytrime Dervisholli dhe Nora Hasani

Koordinimi: Zyra e KAS në Prishtinë

Printimi dhe Dizajni: Milky Way Creative

Fotografitë: Arben Lllapashtica

Punimi mund të shkarkohet në:  
<http://www./kas.de/Kosovo>

Pikëpamjet e paraqitura në këtë manual janë pikëpamjet personale të autoreve dhe nuk paraqesin pikëpamjet e Fondacionit Konrad-Adenauer, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe/ose Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare.

KDWV-OEGJK





## **PËRMBAJTJA**

Hyrje – mesazh nga autorët	7
Informata të përgjithshme për Kosovën	10
Klima e investimeve	16
Sektorët me potencial për të investuar	26
Storie të suksesit	32
Investimet e huaja direkte në Kosovë	36
Tregtia e jashtme	44
Tregtia në shërbime	48
Qasja në treg dhe Marrëveshjet për Tregti të Lirë	52
Ligji i Punës	56
Fuqia punëtore dhe tregu i punës në Kosovë	62
Infrastruktura dhe Energjia	68
Ekosistemi i të bërit biznes	72
Politikat fiskale	76
Shërbimet bankare dhe financiare	80
Zonat industriale – Parqet e biznesit	84
Anëtarësia në organizatat ndërkombëtare	88
Kontakte të rëndësishme	92





## Hyrje

### Një mesazh nga autoret

Kosova është shteti më i ri evropian, në kuptimin e plotë të fjalës: Me mbi 70% të popullsisë nën moshën 35 vjeçare ka demografinë për të cilën ëndërron çdo shtet. Është vend i gjallë, me të rinj të arsimuar në frymë perëndimore, që flasin gjuhë të huaja dhe mund të përshtaten shpejt. Si një shtet i ri, që ka shpallur pavarësinë në 2008, Kosova ofron mundësi ende të pashfrytëzuara për të bërë biznes. Me shkallën më të shpejtë të rritjes

ekonomike në Ballkanin Perëndimor, Kosova po bëhet gjithnjë më tërheqëse për investitorët e huaj.

Shumë kompani që kërkojnë furnizues potencial ose që janë të interesuara për ta zhvendosur prodhimtarinë më afër shteteve anëtare të BE-së e kanë kthyer fokusin kah Ballkani Perëndimor! Kjo është mundësia e artë për Kosovën – sepse ne jemi konkurrues! Përmes Marrëveshjes së Stabilizim

Asociimit, Kosova ofron qasje falas në tregun e BE-së dhe kosto të ulët të punës në krahasim me Evropën Qendrore dhe Lindore, por gjithashtu krahasuar me vendet fqinje, përshkak të një popullsie të re. 28, 2% e popullsisë flet një gjuhë të huaj dhe 11, 4% më shumë se një! Kosova ofron cilësi gjermane me çmime të Kinës.

Përveç potencialit për t'u bërë furnizues për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, Kosova ka një avantazh shtesë, i cili tani

është më i nevojshëm se kurrë: Një komunitet të fortë të TIK dhe të Start-Up-eve! Kosova si një "Start-Up Nation" ka shumë për të ofruar: zgjidhje, produkte e shërbime inovative, duke përfshirë këtu dhe printim 3D. Digjitalizimi është e ardhmja dhe të gjithë po e ndjekin atë: ndërmarrjet dhe korporatat, por edhe institucionet publike – Kosova është në hap me këto zhvillime dhe ofron shumë mundësi për shërbime nearshoring dhe outsourcing për klientë të huaj.

Për të tërhequr investimet e huaja, Kosova ka krijuar një kornizë ligjore që u garanton investitorëve të huaj të drejtën e përfshirjes dhe trajtimit kombëtar në pothuajse çdo sektor të ekonomisë, duke siguruar stimuj tërheqës për kompanitë e huaja në vend.

Kosova ka një pozitë të shkëlqyeshme gjeostrategjike, një ekonomi me kosto konkurruese dhe norma të ulëta tatimore, një fuqi punëtore të re me aftësi të reja të cilat janë

vazhdimisht në rritje – dhe një angazhim për integrimin global të tregtisë! Kosova siguron qasje pa taksa në tregun e BE-së, rajonin e CEFTA-s dhe tregun turk, siç parashikohet nga marrëveshjet tregtare në të cilat merr pjesë.

Ne kemi hartuar këtë udhëzues për t'ju ndihmuar të mësoni më shumë se pse duhet të zgjidhni të investoni në Kosovë. Udhëzuesi përfshin mjedisin ligjor dhe rregullator me të cilin do të përballen investitorët kur investojnë në Kosovë. Sigurisht, çdo vendim për investime është i ndryshëm dhe ligjet dhe rregulloret e zbatueshme kombëtare vazhdimisht evoluojnë me qëllim të përmirësimit të mjedisit të përgjithshëm të të bërit biznes, në përputhje me legjislacionin e BE-së. Ky udhëzues ka për qëllim të sigurojë një përmbledhje gjithëpërfshirëse të çështjeve dhe nuk është domosdoshmërisht një opinion ligjor, i zbatueshëm për të gjitha investimet. Kosova ka krijuar një kornizë

institucionale që do të udhëzojë investitorët në çdo fazë të procesit të tyre të investimeve duke lehtësuar qasjen në të gjitha informacionet e kërkuara dhe duke ndihmuar në kapërcimin e çdo barriere administrative që mund të haset.





01

**INFORMATATA  
TË PËRGJITHSHME  
PËR KOSOVËN**

## INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KOSOVËN

Republika e Kosovës ndodhet në zemër të Gadishullit Ballkanik dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 10,887 km<sup>2</sup>. Kufizohet me Serbinë në veri dhe në lindje, me Maqedoninë e Veriut në jug, me Shqipërinë në jugperëndim dhe me Malin e Zi në veriperëndim.

Republika e Kosovës është shteti më i fundit pasardhës i ish Jugosllavisë, që ka shpallur pavarësinë e saj

në 17 Shkurt 2008. Sot ajo njihet si një shtet i pavarur nga më shumë se 100 Shtete Anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe nga 23 nga 28 Shtetet Anëtare të Bashkimi Evropian (BE). Kosova është një kandidat i mundshëm për anëtarësimin në BE dhe nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) me BE në Tetor 2015, që ka hyrë në fuqi në prill 2016.

# 01





Kryeqyteti i vendit është Prishtina, një nga kryeqytetet më të gjalla në Gadishullin Ballkanik. Kosova ka një popullsi prej rreth 1.8 milion, me shqiptarët e Kosovës që formojnë shumicën në mbi 93% të popullsisë së përgjithshme, ndërsa pakicat përfshijnë boshnjakët e Kosovës (1.6%) dhe serbët e Kosovës (1.5%). Përafërsisht 44% e sipërfaqes tokësore të Kosovës përbëhet nga pyje. Kosova ka një biodiversitet të gjerë dhe unik, pjesërisht për shkak të strukturës së saj

malore të terrenit (6% të sipërfaqes totale).

Kosova është shtet sekular, njerëzit janë pro-perëndimor dhe shumë mikpritës. Vendi ofron jetesë cilësore, me kosto të ulët. Është vend me mundësi të shumta të turizmit brenda Kosovës (turizëm rural dhe malor), dhe meqë ka pozitë të mirë gjeografike dhe qasje në autostrada, nga Kosova mund të arrini shpejt në Shqipëri, Kroaci, Greqi dhe Mal të Zi, për të përmendur vetëm disa nga destinacionet e afërta.



## PËRSHKRIM I EKONOMISË

Kosova është një vend i pasur me burime natyrore dhe me potencial të bollshëm për zhvillim ekonomik. Ka një regjim tregtar liberal të bazuar në parimet e ekonomisë së tregut, me konkurrencë të lirë që favorizon hapjen e tregjeve, si e vetmja mundësi për ngritje të qëndrueshme të aftësisë konkurruese.

Në vitin 2018, rritja ekonomike ishte 4% sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar. Motori kryesor që nxit ekonominë është paratë nga transfertat e

diasporës (remitancat) të cilat investohen kryesisht në konsum privat dhe blerje të pasurive të patundshme.


Në vitin 2019, shkalla e punësimit është 30.1 %, shkalla e papunësisë është 25.7 % ndërsa shkalla e jo aktivitetit (fuqia punëtore e cila nuk është duke kërkuar punë) është 59.5 %. Megjithëse, papunësia aktuale mund të jetë më e ulët për shkak të statistikave të pamjaftueshme që mbulojnë sektorin informal.

Emri zyrtar:	Republika e Kosovës
Forma qeverisjes:	Republikë unitare parlamentare kushtetuese
Sipërfaqja:	10,887 kilometra katrorë
Popullsia (2011):	1,739,825
Dendësia:	159 njerëz për km <sup>2</sup>
Feja:	Myslimane, Katolike, Ortodokse Serbe
Komuna:	38
Monedha:	Euro
Zona kohore:	CET
PBB për kokë banori, aktualisht US\$:	4,458
PBB, aktualisht S\$ billion:	8.0
Rritja e PBB-së:	4% mesatare
Vëllimi total i importeve (2018):	4.4 miliardë dollarë
Vëllimi i përgjithshëm i eksporteve (2018):	2.1 miliardë dollarë
Investime të huaja direkte (2018):	240.1 milion dollarë ose 4.01% e PBB-së

EMRI ZYRTAR:  
REPUBLIKA E  
**KOSOVËS**

FORMA      **REPUBLIKË UNITARE**  
QEVERISJES: **PARLAMENTARE KUSHTETUESE**

SIPËRFAQJA:  
**10,887**   
KILOMETRA KATRRORË

POPULLSIA (2011):  
 **1,739,825**

DENDËSIA: **159** NJERËZ  
PËR KM2 

FEJA: **MYSLIMANE,  
KATOLIKE,  
ORTODOKSE SERBE**

KOMUNA:  
**38**  MONEDHA:  
**EURO**

**2.1** VËLLIMI I PËRGJITHSHËM  
I EKSPORTEVE (2018):  
**MILIARDË DOLLARË**

ZONA KOHORE:  
 **CET**

PBB  
PËR KOKË  
BANORI, **4,458**  
AKTUALISHT US\$:

VËLLIMI TOTAL  
I IMPORTEVE (2018): **4.4** **MILIARDË  
DOLLARË**

PBB, AKTUALISHT  
S\$ BILLION: **8.0**

**240.1** INVESTIME  
TË HUAJA  
MILION DOLLARË DIREKTE (2018):  
OSE **4.01%**  
E PBB-SË

RRITJA E PBB-SË:  
MESATARE **4%**



02

**KLIMA  
E INVESTIMEVE**



# KLIMA E INVESTIMEVE

Pse të investohet  
në Kosovë?

# 02

Mjedisi afarist në Republikën e Kosovës është duke u bërë ndër më konkurruesit në rajon. Një sistem i shkëlqyeshëm tatimor, një burime të shumta natyrore, metoda të shpejta dhe të lehta të regjistrimit të biznesit dhe ligje transparente për investimet e huaja janë vetëm disa nga avantazhet që e bëjnë Kosovën një mjedis tërheqës dhe miqësor për investitorët e huaj.

Në Raportin e Bankës Botërore Të Bërit Biznes (Doing Business) për vitin 2020 Kosova renditet në vendin e 57-të, me një

përmirësim prej 2.2 % drejt praktikës më të mirë ndërkombëtare. Raporti njohu Kosovën për reforma domethënëse në pesë fusha specifike: mbrojtje të investitorëve të pakicave, leje ndërtimi, besueshmëri të furnizimit me energji elektrike, zbatim të kontratave dhe tregti përtej kufijve. Republika e Kosovës është vendi me mundësitë më të mëdha për investime në Ballkan dhe tërheq investitorët ndërkombëtarë që ta konsiderojnë Kosovën si një vend kryesor për investimet e tyre.

- ✓ **70%** e popullsisë janë nën 35 vjeç
- ✓ Koncentrimi më i madh i gjermanisht-folësve, pas vendeve të **DACH (Gjermania, Austria dhe Zvicra)**
- ✓ Popullsia mbi **15 vjeç**, që flet
  - ▶ vetëm gjuhën amtare **55,7%**
  - ▶ një gjuhë të huaj **28,2 %**
  - ▶ dy gjuhë të huaja **11,4 %**
  - ▶ tri gjuhë të huaja **4,5 %**
- ✓ niveli i ulët i pagave
  - ▶ opaga mesatare mujore në sektorin privat **384 € / bruto**
- ✓ kosto e ulët e jetesës
- ✓ norma tatimore të ulta
  - ▶ Tatimi në fitim është 10%
  - ▶ Tatimi në të ardhura personale (sistem shkallor): 0-10%
  - ▶ Dividenda: 0%

- ✓ Euro është valuta zyrtare

---

- ✓ Mundësi të mira për eksport
  - ▶ Qasje e lirë në tregjet e vendeve të BE-së (marrëveshja e MSA)
  - ▶ Qasje e lirë në tregun e Turqisë (marrëveshja e tregtisë së lirë me Turqinë)
  - ▶ Qasje e lirë në tregun e Mbretërisë së Bashkuar (marrëveshja hyn në fuqi me datë 01.01.2021)
  - ▶ Qasje në tregjet e vendeve të CEFTA-s

---

- ✓ Sistemi bankar i qëndrueshëm

---

- ✓ Pozita gjeografike, qasje në autostrada dhe në Portin e Durrësit dhe Selanikut

---

- ✓ Depërtimi i internetit është **88,8 %**





## INCENTIVAT PËR INVESTIME

Korniza ligjore aktuale në Kosovë lejon incentivat për investitorë të huaj dhe vendor. Qëllimi i tyre është për të promovuar rritjen e sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM). Sipas Ligjit për Investimet e Huaja, investitorët e huaj kanë të drejta dhe obligime të barabarta sikurse banorët e Kosovës dhe trajtohen barabartë. Incentivat aktuale mbulojnë çështjet si më poshtë:

### 1 BARTJA E HUMBJEVE

Ligji për Tatimin e të Ardhurave në Korporata për përcakton bartjen e humbjes deri në gjashtë (6) vite.

### 2 ZBRITJET E VEÇANTA PËR ASETET E REJA

Nëse një tatimpagues blen linjat prodhuese për uzina dhe makineri, inventarë të hekurudhës dhe lokomotiva që shfrytëzohen për transportin hekurudhor, aeroplanë, anije, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda për qëllimet e aktiviteteve ekonomike të tatimpaguesit, lejohet një zbritje e veçantë prej dhjetë përqind (10%) të





çmimit të përvetësimit të pasurisë në vitin në të cilin pasuria është vënë për herë të parë në shërbim. Kjo bëhet krahas zbritjes normale të zhvlerësimit të lejueshëm dhe vetëm nëse pasuria është e re ose është vënë për herë të parë në përdorim në Kosovë. Zbritja nuk lejohet nëse pasuria është bartur nga një biznes ekzistues ose një biznes i mëparshëm në Kosovë.

### 3 SHMANGJA NGA TATIMI I DYFISHTË

Tatimpaguesi rezident në Kosovë që përfiton të ardhura nga aktivitetet afariste jashtë Kosovës dhe i cili paguan tatimin në të ardhura në shtete tjera sipas këtij ligji i lejohet një kredi tatimore për tatimin në të ardhura të paguar në shtetin tjetër që i atribuohet të ardhurave që krijohen në shtetin tjetër. Kreditimi tatimor i lejuar është i kufizuar në shumën e tatimit të jashtëm të paguar në të


ardhurat e përfituara jashtë Kosovës, e nuk tejkalon shumën e tatimit obligues në Kosovë në ato të ardhura. Për aq sa tatimi i Kosovës në ato të ardhura tejkalon tatimin e jashtëm të paguar, shumta tepriçë duhet të përfshihet në llogaritjen e tatimit obligues të Kosovës.

## 4 TOKA

Komunat e Kosovës kanë të drejtë që të japin me qira pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme investitorëve të huaj. Dhënia me qira mund të bëhet për kohë prej dhjet vitesh me mundësi vazhdimi për deri 99 vjet.

## 5 KOSTO E ULËT E OPERIMIT

Përparësia kryesore e fuqisë punëtore Kosovare është kostoja e ulët operative. Paga mujore neto midis 300 dhe 400 €.





## MBROJTJA E INVESTITORËVE

Ligji për investimet e huaja ka për qëllim të rregullojë mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja në Republikën e Kosovës, t'u ofrojë investitorëve të huaj të drejta dhe

garanci themelore, që u japin siguri investitorëve të huaj që investimet e tyre të mbrohen dhe të trajtohen në mënyrë të drejtë në pajtim me standardet dhe praktikatat e pranuar ndërkombëtare.

Në veçanti, të drejtat që i takojnë një investitori të huaj janë:

- ▶ Trajtimi jo-diskriminues
- ▶ Mbrojtja dhe siguria e vazhdueshme
- ▶ Kompensimi në rast të nacionalizimit apo shpronësimit, duke përfshirë edhe pagesën e interesit
- ▶ Kompensimi në rast të shkeljeve të ligjeve të aplikueshme dhe ligjit ndërkombëtar për Kosovën
- ▶ Transferimi i lirë si dhe përdorimi i pakufizuar i të ardhurave
- ▶ Mbrojtja ndaj aplikimit retroaktiv të ligjeve

Vlen të theksohet se MSA parashikon mbrojtjen e investitorëve ku sipas nenit 98 të MSA-së, parashihet krijimi i një bashkëpunim në mes të palëve për të mbrojtur investimet e huaja

direkte duke sjellur një klimë më të mirë për investitorët e brendshëm, si dhe të jashtëm, gjë esenciale për revitalizimin ekonomik dhe industrial të Kosovës.


## **MARRËVESHJET BILATERALE PËR PROMOVIMIN DHE MBROJTJEN E INVESTIMEVE**

Qeveria e Kosovës ka nënshkruar disa marrëveshje bilaterale lidhur me promovimin dhe mbrojtjen e investimeve, me: SHBA (OPIC), Gjermaninë, Austrinë, Turqinë, Shqipërinë, Belgjikën, Luksemburgun, Zvicrën, Maqedoninë e Veriut, Kroacinë, Malin e Zi, Kuvajtin, Kanadanë dhe Katarin.

## **LIGJI PËR INVESTIMET STRATEGJIKE**

Qëllimi kryesor i këtij ligji është eliminimi i barrierave, procedurave burokratike – penguese të deritashme – procedurave të stërgjatura e deri te rritja e transparencës për realizimin e investimeve të huaja në Republikën e Kosovës. Ai i mundëson Qeverisë që të negociojë drejtpërdrejtë me investitorët e huaj, por edhe ata vendorë. Njëkohësisht, ofron kushte të barabarta në aspektin e tërheqjes së investitorëve të huaj, në krahasim me vendet fqinje dhe vendet e rajonit.

Investitori i parë strategjik në Kosovë dhe njëkohësisht investitori më i madh gjerman në Kosovë, SOWi Kosova: Projekti parasheh ndërtimin e një parku të erës 105 MW, 30 turbina me erë me kosto prej 150 milion EUR. SoWi është investimi më i madh i huaj që nga themelimi i shtetit në vitin 2008.







16.05  
08.80  
78.68  
8.92  
2.09

80.5 \$  
70.2 \$  
63.6 \$  
55.8 \$

43.9 \$

03

**SEKTORËT  
ME POTENCIAL  
PËR TË INVESTUAR**

# SEKTORËT ME POTENCIAL PËR TË INVESTUAR

Kosova ka një numër të sektorëve që ofrojnë mundësi të mira të biznesit siç janë:

## 03

### Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

(TIK) – Sektori i TIK-ut në Kosovë është relativisht i ri, por po zhvillohet me shpejtësi, siç dëshmohet nga të dhënat e Barometrit të TI-së, të publikuara nga Shoqata e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës. 61% e kompanive të IT-së punojnë për tregun ndërkombëtar dhe sektori i IT-së është sektori i vetëm me një bilanc tregtar pozitiv. Tregjet më të mëdha për Kosovën janë Evropa Perëndimore dhe Amerika e Veriut. Sektori i TIK-ut në Kosovë ka dy përparësi kryesore: disponueshmërinë e hapësirës së punës me kosto të përballeshme dhe qasjen te inkubatorët dhe në accelerator.

### Minierat dhe Energjia

Kosova ka një pasuri të konsiderueshme të burimeve natyrore. Me 14.7 milion ton, Kosova renditet e pesta në botë me rezerva më të mëdha të linjitit. Përveç kapaciteteve gjeneruese të energjisë me qymyr (linjit), Kosova mund të ofrojë mundësi të mëdha në sektorin e energjisë së rinovueshme. Aktualisht rreth 98 përqind e energjisë elektrike prodhohet nga termocentralet

### Turizmi

Pasuritë e mëdha natyrore të Kosovës paraqesin resurse turistike të cilësisë së lartë. Potenciali i vendit për turizëm lidhet kryesisht me pozicionin e tij gjeografik. Jugu malor i Kosovës ka potencial të madh për turizëm dimëror dhe disa nga mundësitë më interesante për investitorët e huaj në këtë rajon janë resorti turistik i skijimit Brezovica dhe Malet e Sharrit.

### Përpunimi i Ushqimit

Klima e Kosovës është e ndikuar nga afërsia e detit Adriatik dhe Egje, si dhe në pjesën veriore konsiderohet tokë kontinentale evropiane. Klima e përgjithshme është një lloj klime kontinentale e modifikuar. Me rreth 60 përqind e popullsisë që jeton në zonat rurale dhe kryesisht punojnë në bujqësi, Kosova ka një traditë të gjatë bujqësore. Bujqësia është njëri nga burimet

kryesore i të ardhurave për shumicën e popullsisë. Sektori i agrobiznesit dhe përpunimit të ushqimit është tradicionalisht një nga sektorët më të fortë në ekonominë e Kosovës.

### Përpunimi i Drurit

Mbi 40 përqind e tokës së Kosovës është e mbuluar me pyje, ose një sipërfaqe prej rreth 465.000 hektarë. Kosova ka një traditë të gjatë të përpunimit të drurit dhe tokat e saj në përgjithësi janë të pasura me lëndë ushqyese duke siguruar një rritje shumë të mirë për bimët natyrore dhe pemë. Në vitin 2015 Kosova ka eksportuar rreth 2.5 milion Euro; në vitin 2016 rreth 6 milion Euro; në vitin 2017 7 milion Euro dhe në vitin 2018 10.5 milion Euro (burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës).

### Industria e Përpunimit të Metalit

Kosova ka një histori të gjatë të përpunimit të metaleve dhe ky sektor ka pësuar ndryshime të mëdha gjatë këtyre njëzet viteve të fundit. Shumë kompani metal-përpunuese të Kosovës, tanimë janë furnitorë për kompani ndërkombëtare. Ky sektor eksporton një gamë të gjerë të produkteve të metalit, kryesisht shiritat të gravurës të çelikut dhe metal të farkuar në 15 vende evropiane.





## **INDUSTRIA E PLASTIKËS DHE GOMËS**

Kategori e rëndësishme në strukturën e eksporteve janë produktet që i përkasin sektorit të plastikës dhe gomës, i cili reflekton një rritje të vazhdueshme nga viti në vit. Në vitin 2015 Kosova ka eksportuar 23.5 milion Euro; në vitin 2016 30 milion Euro; në vitin 2017 37 milion Euro dhe në vitin 2018 46.5 milion Euro. (burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës).

## **PRODUKTET BIMORE**

Pozicioni gjeografik, konfigurimi i relievit, përbërja gjeologjike dhe klima e Kosovës sigurojnë florë të pasur dhe mjaft interesante; një numër i madh i bimëve endemike dhe steno-endemike janë burime të rëndësishme natyrore. Prandaj, produktet bimore (mjekësore dhe aromatike) janë të kërkuara për eksport. Produktet bimore kanë përfaqësuar 4.8% të eksporteve të përgjithshme të Kosovës në vitin 2015, 5.4% në vitin 2016, 6.3 % në vitin 2017 dhe 6.5% në vitin 2018 (burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës).

### **Industria e Ndërtimit**

Gjatë viteve të fundit industria e ndërtimit u bë një nga sektorët më të rëndësishëm që kontribuojnë në rritjen ekonomike të Kosovës. Industria e ndërtimit mbetet një sektor potencial dhe shumë premtues ekonomik për Kosovën.

### **Industria e Tekstilit**

Me mbi 200 vjet traditë, tekstili ka qenë sektori i dytë më i madh industrial në Kosovë, pas minierave. Në të kaluarën, produktet nga prodhuesit kosovarë kishin shënjestër tregun lokal, si dhe tregje të tjera në të gjithë ish-Jugosllavinë, Evropën Perëndimore, Lindore si dhe Shtetet e Bashkuara.

### **Industria e Gurëve Dekorativ**

Disponueshmëria e një prej gurëve dekorativ më të bukur në botë është një nga sekretet më të fshehura të Kosovës. Gjeologjia e Kosovës është e pasur dhe e llojllojshme dhe evoluimi i saj me kalimin e kohës ka qenë i ndikuar nga vendndodhja e saj.





04

**STORIE  
SUKSESI**



## STORIE SUKSESI

# 04

Pavarësisht se ishte një nga vendet më të vogla në Evropën Juglindore, për shkak të popullsisë së saj të re me një prirje për mësimin e shpejtë të gjuhëve të huaja dhe lidhjeve të ngushta me diasporën, veçanërisht në rajonin gjermanisht-folës, Kosova ka arritur të tërheqë interesimin e kompanive të huaja. Interes të veçantë kanë treguar ata që kërkojnë të transferojnë shërbime (outsourcing) ose të zhvendosin prodhimin në Ballkanin Perëndimor. Kështu, në vitet e fundit vërejmë një prezencë më

të madhe të qendrave të thirrjeve të llojit inbound, që ofrojnë kujdes ndaj klientëve dhe shërbime administrative për klientë me repute ndërkombëtare. Në Kosovë operojnë IQ to Link (pjesë e Webhelp), që punëson mbi 1.000 persona, por edhe kompani të tjera të shquara në këtë sektor, siç janë SPEEX, Sutherland dhe Teleperformance. Për shkak të MSA-së dhe procedurave të thjeshta për të bërë biznes, disa kompani kanë hapur degë, apo zhvendosor prodhimin e tyre në Kosovë dhe janë të orientuar vetëm drejt eksportit. Ndër investimet më të suksesshme të huaja në Kosovë, që duam t'i veçojmë, janë: KIVO – KIVO Plastic Packaging nga Holanda, që ka më shumë se 320 punonjës dhe operon në 3 lokacione në 2 shtete, njëri ndër ta është Kosova. Prodhimi në Kosovë filloi në shkurt 2015, me 30 të punësuar në një fabrikë të re me 3.500 metër katror. Fabrika Heinze Group nga Gjermania, me degë në Republikën Çeke, Gjermani

dhe Zvicër, është një lider në teknologjinë dhe inxhinierinë plastike në sektorin e ndërtimit. Heinze Group filloi me prodhimin në Kosovë të një produkti të patentuar, COBIAX. Me zhvillimin dinamik të sektorit të teknologjisë së informacionit në Kosovë, ka investime të suksesshme edhe këtu. Një nga kompanitë e huaja në sektorin e TI është njëbrirësh/unicorn (njëbrirësh/ në apektin financiar: kompani start-up që vlerësohet me mbi 1 miliardë euro) nga Mynihu i Gjermanisë – Kompania CELONIS. Celonis është kompani me bazë në Mynih dhe New York dhe lider global në fushën e process mining, teknologji e cila mundëson transformimin e bizneseve duke i përmirësuar proceset e tyre dhe bërë ato më transparente dhe efikase. Celonis tani e dy vite e ka hapur zyrën në Prishtinë, me një ekip prej më shumë se 50 personave të cilët janë kryesisht të fokusuar në zhvillimin e produkteve Intelligent Business Cloud e që njëherit paraqet veglën më të fuqishme në botë për analizimin,

përpunimin dhe transformimin e të gjitha proceseve biznesore.

Kosova ka arritur të tërheq edhe brende të njohura ndërkombëtare. Ndër fraçizat më të njohura janë:

**BURGER KING**  
**CINEPLEXX**  
**DOMINO'S**  
**FAMIGLIA**  
**KFC**  
**ROSSMANN**  
**SHELL**





SACMI

EURO-COIL

05

**INVESTIMET  
E HUAJA DIREKTE**

## INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

# 05

Në Evropën Jug-lindore, rritja e investimeve të huaja direkte (IHD) ka qenë kryesisht nga investitorët evropianë. Vendet e euro zonës (Gjermania, Austria, Holanda, Greqia dhe Italia) janë investitorët më të rëndësishëm në rajon ndërsa, investitorët nga Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Kina janë duke u rritur me shpejtësi.<sup>1</sup>


### Investimet e huaja direkte në Ballkanin Perëndimor 2016–2018

Vendi	2016	2017	2018
Shqipëria	1 100	1 146	1 294
Bosnja dhe Hercegovina	319	448	468
Maqedonia	374	205	737
Mali i Zi	226	557	490
Serbia	2 350	2 871	4 126

Burimi: UNCTAD World Investment Report 2019  
<https://unctad.org/en/Pages/DIAE/World%20Investment%20Report/Country-Fact-Sheets.aspx>

<sup>1</sup>UNCTAD World Investment Report 2019

## Investimet e huaja direkte në Kosovë 2008–2018



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës/Raporti vjetor

Rritja e IHD-ve u evidentua kryesisht tek patundshmëritë, sektori i minierave, energjetika dhe tregtia, ndërsa shërbimet financiare dhe sektori i ndërtimitarisë kanë shënuar rënie. Sa i përket origjinës së IHD-ve, Zvicra, Gjermania, Shqipëria, SHBA, Britania e Madhe, Emiratet e Bashkuara Arabe, Franca, Norvegjia, Turqia, Bullgaria, etj, përbëjnë shumën më të madhe të IHD-ve në Kosovë.<sup>2</sup>

### VËSHTRËSITË GJATË PROCESIT TË INVESTIMIT NË KOSOVË DHE RËNDËSIA E BASHKËPUNIMIT RAJONAL

Kosova në vazhdimësi është duke punuar që të zhvillojë politika gjithëpërfshirëse për të tërhequr Investimet e Huaja Direkte përmes mekanizmave mbështetëse.

### SFIDAT PËR TË INVESTUAR NË KOSOVË DHE RËNDËSIA E BASHKËPUNIMIT RAJONAL

Kosova vazhdimisht po punon për të zhvilluar politika gjithëpërfshirëse për tërheqjen e investimeve të huaja direkte duke zgjeruar mekanizmat përkrahës.

Ndërsa investimet e huaja janë thelbësore për zhvillimin ekonomik, Kosova nuk perceptohet gjithmonë si një

destinacion ideal për investime. Si pengesa janë cilësuar: tregu i vogël, procedurat burokratike në marrjen e licencave; korrupsioni dhe nepotizmi; mjedisi i paqendrueshëm politik; infrastruktura fizike; sistemi i dobët arsimor; administratë publike jo-efikase; shkalla e lartë e ekonomisë jo-formale; mos zbatimi i

<sup>2</sup>Banka Qendrore e Kosovës / Raporti vjetor

kontratave si pasojë e sistemit gjyqësor jo-efikas dhe furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike.<sup>3</sup>

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar në luftimin e informalitetit dhe korrupsionit, të dyja çështjet janë sfida të përhapura në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Sidoqoftë, çelësi i suksesit në zhbllokimin e potencialit të investimeve është bashkëpunimi rajonal. Çdo vend në Ballkanin Perëndimor është i vogël më vete, por së bashku, si palë zbatuese të marrëveshjes CEFTA, ato sjellin vlerë më të madhe, përfshirë tërheqjen e IHD-ve, me një treg prej rreth 25 milion konsumatorësh.

Që nga viti 2017, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë rënë dakord përmes Procesit të Berlinit për një agjendë të përbashkët në 4 fusha: tregti, investime, mobilitet dhe digjitalizim. Përmes kësaj agjende të përbashkët synohet që të rriten shkëmbimet tregtare, investimet e huaja direkte dhe lëvizja e lirë e profesionistëve. Sa i

përket agjendës së digjitalizimit vlen të theksohet se në muajin Prill të vitit 2019 është nënshkruar Marrëveshja mbi Reduktimin e Çmimeve të Shërbimeve Roaming në Rrjetet Publike të Komunikimit Celular në Rajonin e Ballkanit Perëndimor.



<sup>3</sup>Sytrime Dervisholli "Opportunities to Foreign Investment in Kosovo", September 2011, pg-35-36

## LEGJISLACIONI

Të gjitha ligjet në Kosovë publikohen në Gazetën

Zyrtare: <https://gzkrks.govnet/>

Në gjuhët zyrtare të Kosovës: Shqip dhe Serbisht. Ligjet gjithashtu publikohen edhe në gjuhën angleze.

Në mënyrë që ekonomia të funksionojë në përputhje me parimet perëndimore të tregut të lirë, nga Kuvendi i Kosovës janë aprovuar ligjet si në vijim:

• [Ligji për Investimet e Huaja](#)

• [Ligji për Falimentim](#)

• [Ligji për Investime Strategjike](#)

• [Ligji për Kamatë–Vonesat Tregtare](#)

• [Ligji për Akreditim](#)

• [Ligji për Profesionet e Rregulluara](#)

• [Plotësim ndryshimi i Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta](#)

• [Ligji për Trepçën](#)

• [Ligji për Treguesit Gjeografik dhe për Emërtimet e Origjinës](#)

• [Ligji për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore](#)

• [Ligji për Shërbimet](#)

• [Ligji për Shoqëritë Tregtare](#)

• [Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit](#)

• [Ligji për Produktet e Ndërtimit](#)

• [Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për procedurën përmbartimore](#)<sup>4</sup>

• [Ligji për Ndërmjetësim](#)<sup>5</sup>

• [Ligji për Arbitrazhin](#)<sup>6</sup>

• [Ligji për Avokatinë](#)<sup>7</sup>

• [Ligji për Dizajnin Industrial](#)

• [Ligji për Markat Tregtare](#)

• [Ligji për Patenta](#)

• [Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës](#)

• [Ligji për Ndhimën Shtetërore](#)

Ndërsa, që një kohë të gjatë janë në fuqi edhe Ligji për Tregti të Brendshme dhe Ligji për Tregti të Jashtme që aktualisht gjenden në fazën e plotësim/ndryshimit.

<sup>4</sup> <https://mdrks-govnet/page.aspx?id=145>

<sup>5</sup> <https://mdrks-govnet/desk/inc/media/0284D2EC-42BD-43DC-AE73-76C1DC8E74DC.pdf>

<sup>6</sup> <https://gzkrks-govnet/ActDetail.aspx?ActID=2579>

<sup>7</sup> <http://www.oak-ks.org/sq/lista-e-avokateve>



## EKONOMIA

### Vështrim makroekonomik

Me 29 Qershor 2009, Kosova është anëtarësuar në Bankën Botërore dhe në Fondin Monetar Ndërkombëtar. Kosova ka një politikë fiskale stabile. Baza e të ardhurave tatimore është zgjeruar duke mundësuar rritjen e shpenzimeve qeveritare dhe si kthim i kësaj të mbështesë rritjen ekonomike. Përveç performancës së mirë ekonomike, Kosova ka një politikë monetare stabile. Kosova është një prej vendeve jashtë zonës së BE-së që ka në përdorim valutën e Euros, si valutë

zyrtare. Përdorimi i Euros ka siguruar inflacion të ulët dhe mjedis stabil makroekonomik. Rritja ekonomike gjatë vitit 2019 vlerësohet të ketë qenë më e dobët krahasuar me vitin 2018. Këto vlerësime mbështeten në zhvillimet jo aq të favorshme në sektorin e jashtëm (rënies së eksportit të mallrave dhe shërbimeve, rënies së IHD-ve, përshpejtim të rritjes së importit, etj.) si dhe rënies së kredive të reja konsumuese dhe investuese.

Përshkrimi	2016	2017	2018
GDP (në milion Euro)	6,043.1	6,326.2	6,659.0
Punësimi	28.0%	29.8%	28.8%
Papunësia	27.5%	30.5%	29.6%
Remitencat (në milion Euro)	691.0	759.2	800.5

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës – buletini mujor statistikor, Janar 2020 / Nr.221 – [https://bqk-kos.org/repository/docs/2018/BQK\\_BMS\\_221\\_al.pdf](https://bqk-kos.org/repository/docs/2018/BQK_BMS_221_al.pdf)

Tabela më poshtë tregon projeksionet për rritjen ekonomike për vitin 2019, 2020 dhe 2024 sipas rritjes reale të GDP si dhe krahasimi me vendet e rajonit, sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar.


Vendi	2019	2020	2024
Shqipëria	3.0	4.0	4.0
Bosnja dhe Hercegovina	2.8	2.6	3.0
<b>Kosova</b>	<b>4.2</b>	<b>4.0</b>	<b>4.0</b>
Maqedonia e Veriut	3.2	3.4	3.5
Mali i Zi	3.0	2.5	2.9
Serbia	3.5	4.0	4.0

Burimi: IMF World Economic Outlook, October 2019;

[file:///C:/Users/sytrime.dervisholli/Downloads/text%20\(2\).pdf](file:///C:/Users/sytrime.dervisholli/Downloads/text%20(2).pdf)

Duhet theksohet se pandemia COVID-19 ka ndikuar dukshëm në ekonomitë e pothuajse të të gjitha vendeve të botës, përfshirë Kosovën bashkë me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor. Rrjedhimisht, do të ketë ndryshim edhe në projeksionet ekonomike. Sipas Bankës Botërore (grafiku më poshtë), vendet e Ballkanit Perëndimor pritet të hyjnë në

recesion në vitin 2020, ku parashihet që të gjitha 6 vendet të përjetojnë rritje negative pasi do të vazhdojnë të ndjejnë ndikimin ekonomik të pandemisë COVID-19. Rritja rajonale në Ballkanin Perëndimor është parashikuar të jetë në mes të -3 dhe -5.6 përqind, sipas Regular Economic Report (RER) të Bankës Botërore.



Burimi: <https://www.worldbank.org/en/news/press-release/2020/04/29/kosovo-economy-projected-to-contract-by-45-percent-in-2020-due-to-covid-19>

Gjithashtu, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) në raportin e tyre "Regional Economic Prospects, COVID-19: From shock to recovery" ka publikuar të dhënat e prezantuara në tabelën e mëposhtme duke krahasuar me parashikimet e IMF, Bankës Botërore dhe Komisionit Evropian:

### Parashikimet e PBB-së për Ballkanin Perëndimor (%)

	EBRD		IMF		WB		EC	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
Ballkani Perëndimor	-4.8	7.1	-4.2	6.8	-3.1	4.7	-3.0	4.0
Shqipëria	-9.0	12.0	-5.0	8.0	-5.0	8.8	-4.8	4.2
Bosnja dhe Hercegovina	-4.5	6.0	-5.0	3.5	-3.2	3.4		
Kosova	-5.0	7.5	-5.0	7.5	-4.5	5.2		
Mali i Zi	-8.0	10.5	-9.0	6.5	-5.6	4.8	-5.9	4.4
Maqedonia e Veriut	-3.5	5.5	-4.0	7.0	-1.4	3.7	-3.9	4.0
Serbia	-3.5	6.0	-3.0	7.5	-2.5	4.0	-4.1	6.1

Burimi: IMF World Economic Outlook, October 2019;  
[file:///C:/Users/sytrime.dervisholli/Downloads/text%20\(2\).pdf](file:///C:/Users/sytrime.dervisholli/Downloads/text%20(2).pdf)



06

**TREGTIA  
E JASHTME**

## TREGTIA E JASHTME

# 06

Kosova ka një regjim liberal tregtar dhe ka tre përfitime të mëdha nga liberalizimi i tregtisë: mundësi me të mira për eksport, një mjedis më të mirë të investimeve, dhe marrëdhënie të qëndrueshme me fqinjët e saj.

Bilanci tregtar i Kosovës karakterizohet me deficit të lartë tregtar. Referuar të dhënave statistikore kuptojmë që në përbërjen e përgjithshme të shkëmbimeve tregtare importet përfaqësojnë 90% të tregtisë së jashtme kurse eksportet

me një përqindje prej vetëm 10%.


Kosova kryesisht eksporton produkte të plastikës dhe gomës, metale bazë dhe produktet e tij, makineri, pajisje mekanike dhe elektrike, tekstil, këpucë, yndyra ushqimore, produkte nga industria ushqimore dhe pijeve. Ndërsa, kryesisht importon mjete të transportit, ushqime të përgatitura, pije dhe duhan, produkte me origjinë kafshe, produkte të industrisë kimike dhe tekstil.



## Importet dhe eksportet në mallra 2013–2019


Tregtia me vendet e BE-së dhe vendeve të rajonit pjesëmarrës në CEFTA, përbën pjesën më të rëndësishme të shkëmbimeve tregtare të Kosovës, me rreth 73% të gjithë tregtisë së jashtme.

### Eksportet e Kosovës 2013–2019 ('000 €)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

### Importet e Kosovës 2013–2019 ('000 €)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës



07

**TREGTIA  
NË SHËRBIME**




## TREGTIA NË SHËRBIME

# 07

Sipas Organizatës Botërore të Tregtisë, shërbimet përfaqësojnë sektorin më të shpejtë në rritje të ekonomisë globale dhe përbëjnë 2/3 e prodhimit global, 1/3 e punësimit global dhe përafërsisht 20 përqind të tregtisë globale. Ekonomia e Kosovës është kryesisht një "ekonomi e shërbimeve". Sektori i shërbimeve është shfaqur si segmenti më i madh i ekonomisë duke kontribuar me një përqindje të rritur të vlerës së shtuar vendore, punësimit dhe tregtisë. Aktivitetet e shërbimeve në vitin 2017 kanë përbërë 71.9 përqind të PBV-së me çmime bazë, dhe kanë gjeneruar 81.2 përqind të


totalit të punësimit formal në vend. Aktivitetet e shërbimeve përbëjnë 86 përqind të firmave të regjistruara në vend, dhe paraqesin 82.6 përqind të totalit të punësimit në sektorin privat. Aktivitetet e shërbimeve gjenerojnë 87.3 përqind të qarkullimit të përgjithshëm të firmave në ekonomi, dhe përfaqësojnë 88.8 përqind të shpenzimeve të përgjithshme. Sektorët më të zhvilluar ndër vite janë: shërbimet e udhëtimit, shërbimet e ndërtimit, shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit dhe shërbimet e tjera të biznesit.

### Eksporti i shërbimeve 2013–2019 (në '000 €)



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

## Importi i shërbimeve 2013–2019 (në milion €)



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

## Sektorët e shërbimeve me potencial zhvillimi

- ✓ Shërbimet kompjuterike, informacionit dhe të telekomunikacionit
- ✓ Shërbimet tjera të biznesit
- ✓ Shërbimet e ndërtimit





08

**QASJA NË TREG  
DHE MARRËVESHJET  
PËR TREGTI TË LIRË**

## QASJA NË TREG DHE MARRËVESHJET PËR TREGTI TË LIRË

# 08

### Liberalizimi i importit:

- ✓ Linjat e prodhimit dhe pajisjet për prodhim
- ✓ Lënda e parë për prodhim (që nuk prodhohet në Kosovë)
- ✓ Pajisjet e teknologjisë së informacionit (TI)

### Përparësitë tjera:

- ✓ Sistemi Elektronik i Prokurimit
  - ✓ Tatimi në të Ardhurat e Korporatave: 10%
  - ✓ Tatimi mbi të Ardhurat Personale: 0 – 10 % (progressive)
  - ✓ Kontributi pensional i detyruar: 5%
- ✓ Kodi specifik tatimor për zhvlerësim
  - ✓ Në bazë të nenit 15 të Ligjit për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatës (nr.03/L- 162), shuma e lejuar për zbritje të zhvlerësimit për periudhën tatimore do të përcaktohet me aplikimin e përqindjeve të poshtëshënuara për llogaritë kapitale përmes metodës së balancimit të zbritjes:



- ✓ Kategoria 1: Ndërtesat; pesë për qind (5%)
- ✓ Kategoria 2: Automjetet dhe pajisjet për zyre; njëzet për qind (20%)
- ✓ Kategoria 3: Makineritë dhe automjetet për transport të rëndë; pesëmbëdhjetë për qind (15%)

### Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA)

MSA nga 1 Prill 2016 ofron reduktim gradual të taksave doganore pra nga 10% në vitin 2016 në 0% në vitin 2026. Kjo vlen vetëm për produktet bujqësore ndërsa për produktet industriale taksa doganore është zero (0);

<https://dogana.rks.gov.net/per-biznese/marreveshja-stabilizim-asociimi/>

### CEFTA

eksporti dhe importi janë të liruara nga taksat doganore, pra është zero (0); <https://dogana.rks.gov.net/per-biznese/cefta/>

### Marrëveshja e Tregtisë Lirë me Turqinë

kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi me datë 1 Shtator 2019. <https://dogana.rks.gov.net/per-biznese/mtl-kosove-turqi/>

### Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Mbretërinë e Bashkuar

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi me datë 1 Janar 2021. Kosova është vendi i parë nga rajoni i Ballkanit Perëndimor që ka nënshkruar marrëveshje të tregtisë së lirë me Mbretërinë e Bashkuar.

### Sistemi i Përgjithshëm Preferencial (GSP):

Kosova përfiton edhe nga GSP<sup>8</sup> me katër vende: SHBA, Zvicra, Norvegjia dhe Japonia.<sup>9</sup> Kjo nënkupton që eksportuesit kosovarë me rastin e eksportit të mallrave në tregjet e këtyre katër vendeve përjashtohen nga detyrimet doganore për një numër të caktuar të produkteve.

### Kontakti në Doganë /Adresa/Orari i punës:

<https://dogana.rks.gov.net/>; info@dogana-rks.net; +383 38 540 350; Prishtinë; e Hëne – e Premte 08:00-16:00

<sup>8</sup>[https://unctad.org/en/PublicationsLibrary/itcdtsbmisc62rev6\\_en.pdf](https://unctad.org/en/PublicationsLibrary/itcdtsbmisc62rev6_en.pdf)

<sup>9</sup>[https://www.customs.go.jp/english/c-answer\\_e/imtsukan/1504\\_e.htm](https://www.customs.go.jp/english/c-answer_e/imtsukan/1504_e.htm)

# UDHËZUESI PËR TREGTI NDËRKOMBËTARE (ITG)

ITG ka për qëllim të ndihmojë eksportuesit dhe importuesit e mallrave dhe shërbimeve në Kosovë për të kryer transaksione ndërkombëtare të tregtisë. Është i menduar edhe si një udhëzues për kompanitë e huaja që konsiderojnë tregtinë me Kosovën dhe ofron informacione me rëndësi për ta. Ky udhëzues është një mjet interaktiv i bazuar në internet, i projektuar për t'u mundësuar përdoruesve për të marrë një pasqyrë të procedurave të përfshira me transaksionet tregtare si dhe për të kuptuar në thellësi procedurat ose proceset e veçanta: <https://itg-rks.com/>



09

**LIGJI  
I PUNËS**



## LIGJI I PUNËS

Marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësve dhe të punësuarve në Kosovë rregullohen nga Ligji i Punës. Ky ligj ka për qëllim të mbrojë të drejtat e të caktojë detyrimet në marrëdhëniet e punës, dhe të sigurojë mbrojtjen në punë.

Ligji i Punës duhet të sigurojë përmbushjen e katër parimeve kyçe:

- Lirinë e asociimit dhe njohjen e të drejtës për negociata kolektive,
- Zhdukjen e çdo lloji të punës së detyruar dhe të dhunshme,
- Zhdukjen e punës së të miturve,
- Zhdukjen e diskriminit në punë.

# 09

Mbikqyrjen e zbatimit të këtij ligji e bën Inspektorati i Punës. Çdo person fizik apo juridik, që nuk i përfill dispozitat e këtij ligji, penalizohet me masa ndëshkuese.



## Kontrata e Punës dhe Llojet e Kontratave të Punës

Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar.

- Kontrata e punës për periudhë të pacaktuar;
- Kontratë e punës për periudhë të caktuar;
- Kontratë për punë dhe detyra specifike.



Kontratat e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar.

Kontrata për periudhë të caktuar nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite.

Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet (120) ditë brenda një (1) viti.

Elementet e marrëdhënies së punës	Dispozita përkatëse në Ligjin e Republikës së Kosovës
Kontrata	40 orë
Orët e punës në javë	Zbatohet për punët për të cilat punëtori nuk mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme për shëndetin e tij, edhe përkundër aplikimit të masave mbrojtëse
Puna jashtë orarit	Me kërkesën e punëdhënësit në rastet e domosdoshme; më së shumti deri në 8 orë në javë
Pushimi ditor	30 minuta (të përfshira në orarin normal të ditës së punës)
Pushimi javor	Së paku 24 orë
Pushimi vjetor	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Së paku 4 javë në vitin kalendarik (pavarësisht nëse punon me orar të plotë apo të shkurtuar); për çdo 5 vite punë shtohet një ditë pushimi</li> <li>• Përjashtim bëjnë arsimtarët</li> <li>• Festat zyrtare që bien në ditë pune nuk llogariten në ditët e pushimit vjetor</li> </ul>
Pushimi vjetor	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në rast sëmundjeje: 20 ditë pune në vit me kompensim të plotë të pagës</li> <li>• Në rast të pasigurisë dhe mosmbrojtjes së shëndetit në punë: deri në 45 ditë në vit me kompensim të plotë të pagës</li> <li>• Në rast të pushimit mjekësor prej lëndimit ose sëmundjes të shkaktuar nga kryerja e punëve dhe shërbimeve për punëdhënësin: 10 – 90 ditë në vit me kompensim deri në 70% të pagës</li> <li>• 5 ditë në rast të martesës së punëmarrësit</li> <li>• 5 ditë në rast të vdekjes së një anëtarë të ngushtë të familjes</li> </ul> <p>1 ditë për çdo rast të dhënies vullnetare të gjakut</p>

Leja e lehonisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 12 muaj për femrat, duke filluar prej 45 deri 28 ditë para datës së parashikuar të lindjes – kompensimi i rrogës bëhet në masën 70% për 6 muajt e parë, 50% për 3 muajt në vijim dhe 0% në 3 muajt e fundit;</li> <li>• Këto të drejta i realizon babai i fëmijës nëse nëna sëmuret, e braktis fëmijën apo vdes;</li> <li>• Në rastet e tjera, babai ka të drejtë për 2 ditë pushim për lindjen e fëmijës dhe 2 javë pushim të parapaguar derisa fëmija të arrijë moshën 3-vjeçare;</li> <li>• Kushte të tjera zbatohen kur fëmija lind i vdekur ose ka nevojë për përkujdesje të vecantë.</li> </ul>
Paga shtesë	<p>Jepet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 20 % në orë për kujdestari</li> <li>• 30 % në orë për punë gjatë natës</li> <li>• 30 % në orë për punë jashtë orarit</li> <li>• 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave</li> <li>• 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës</li> </ul> <p>Pagesa shtesë për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira e përjashtojnë njëra-tjetrën. I punësuar mund të kërkojë nga punëdhënësi që në vend të pagës shtesë të kompensohet me ditë pushimi.</p>
Puna me orar jo të plotë (min. 20 orë në javë)	<p>Punëmarrësi i kësaj kategorie gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sikurse i punësuar me orar të plotë, por në proporcion me orët që ka punuar. Ai nuk mund të punojë më gjatë se orari i plotë i punës.</p>
Puna provuese	<p>Lejohet për një kohëzgjatje maksimale prej 6 muajsh.</p>

---

**Informata tjera  
të rëndësishme:**

Afatet e njoftimit të shkëputjes së kontratës:  
Në rast të përfundimit të një kontrate pune me një periudhë të pakufizuar, palët njoftojnë njëra-tjetrën përmes njoftimit me shkrim për:

- 7 ditë kalendarike gjatë periudhës së provës prej gjashtë muajsh
- 30 ditë kalendarike gjatë gjashtë muajve të parë deri në dy vjet të punësimit
- 45 ditë kalendarike gjatë dy viteve të para deri në 10 vjet të punësimit
- 60 ditë kalendarike nëse punonjësi ka punuar për njësinë ekonomike për më shumë se 10 vjet.

Sidoqoftë, për të gjitha llojet e kontratave, përfundimi i menjëhershëm mund të ndodhë në çdo kohë për arsye të justifikueshme. Është gjithashtu e mundur që të dy palët mund të bien dakord për të ndërprerë kontratën e punës me marrëveshje të ndërsjellë.

Paga minimale e caktuar me vendim të Qeverisë së Kosovës në vitin 2011 është 130 Euro për të punësuarit e moshës nën 35 vjeç, dhe 170 euro për të punësuarit e moshës mbi 35 vjeç.

Punësimi i shtetaseve të huaj  
Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës themelojnë marrëdhënie pune sipas ligjit të punës së Kosovës, nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetaseve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare.

10

**FUQIA PUNËTORE  
DHE TREGU I PUNËS  
NË KOSOVË**

## FUQIA PUNËTORE DHE TREGU I PUNËS NË KOSOVË

# 10

Kosova është e bekuar me një fuqi punëtore të re, të aftësuar, që flet shumë gjuhë, të motivuar, dhe me një shpirt të lartë sipërmarrësie. Duke e marrë parasysh fuqinë punëtore në dispozicion dhe ligjin liberal të punës që rregullon tregun vendor të punës, punësimi i punëtorëve në Kosovë është efikas dhe i thjeshtë. Pothuajse 2/3 e popullsisë së Kosovës është në moshë pune (15-64 vjeç). Pritet që popullsia në moshë pune të rritet shpejt gjatë dekadës së ardhshme pasi Kosova është ndër vendet me popullsinë më të re në Evropë.



Punësimi sipas nivelit arsimor			
Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Punësimi (në mijëra)			
Pa shkollë	0,3	0,7	10
Fillor	41,9	11,3	53,2
Arsimi i mesëm profesional	136,9	21,8	158,7
Shkollë e mesme gjimnazi	36,1	10,5	46,5
Terciar	64,7	39,0	103,7
<b>Terciar</b>	<b>279,9</b>	<b>83,2</b>	<b>363,2</b>
Shkalla e punësimit (%)			
Pa shkollë	5,2	3,2	3,7
Fillor	27,6	4,1	12,4
Arsimi i mesëm profesional	50,1	14,8	37,7
Shkollë e mesme gjimnazi	42,4	13,6	28,6
Terciar	73,1	49,9	62,2
<b>Terciar</b>	<b>46,2</b>	<b>13,9</b>	<b>30,1</b>

Në Kosovë veprojnë tetë Institucione Publike të Arsimit të Lartë me lokacion në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjiilan, Gjakovë dhe Mitrovicë.


Ndërsa, janë po ashtu afër 30 Institucione Private të Arsimit të Lartë. Shumë nga këto institucione bashkëpunojnë me universitete tjera në botë si me: The Rochester Institute of Technology, University of Sheffield dhe Staffordshire University.



Në Kosovë, në vitin 2018 ishin 37985 studentë në Universitetin Hasan Prishtina. Gjatë vitit 2018 në Unviersitetin e Prishtinës kanë diplomuar 7282 studentë në të tri nivelet e studimit.

Në vitin 2019 shkalla e punësimit nëpër grup moshë ishte më e larta në mesin e personave të moshës mes 35–44 vjeç (39.3%) dhe më e ultë në mesin e të rinjve (15–24 vjeç) (13.1 %).

Në vitin 2019, shumica e të punësuarve kishin pozita pune në: shërbime dhe shitje, në profesione elementare, si profesionistë, dhe si punëtorë zejtarie. Pothuajse gjysma e femrave të punësuar ishin: profesioniste, teknike dhe profesione që lidhen me to (40.3%), 22.6 % në shërbime dhe shitje dhe 11.7% ishin në profesione elementare. Meshkujt ishin më të shpërndarë nëpër sektorë, por shumica ishin të punësuar si: punonjës në shërbime dhe shitje (23.5%), 11.8% si punëtor zejtarë dhe te ngjashëm me të, profesione elementare (23.8%) ndërsa 11.0% ishin profesionistë.



## Punësimi sipas profesioneve dhe gjinisë

Kosovë (mosha 15 e më lartë)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
<b>Punësimi sipas profesioneve (në mijëra)</b>			
Ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë	26,9	5,2	32,1
Profesionistë	31,2	27,2	58,3
Teknikë dhe profesione të lidhura me ta	15,5	6,5	22,0
Nëpunës	12,9	8,5	21,4
Punëtorë shërbyes dhe punëtorë shitës në dyqane dhe tregje	66,5	18,9	85,4
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	8,6	1,6	10,2
Punëtorë zejtarie dhe të ngjashëm me ta	33,4	5,3	38,7
Operatorë fabrikash dhe makinerish dhe montues	20,4	0,5	20,9
Profesione elementare	67,3	9,8	77,2
<b>Gjithsej</b>	<b>282,5</b>	<b>83,6</b>	<b>366,1</b>
<b>Punësimi sipas profesioneve (në mijëra)</b>			
Ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë	9,5	6,2	8,8
Profesionistë	11,0	32,5	15,9
Teknikë dhe profesione të lidhura me ta	5,5	7,8	6,0
Nëpunës	4,6	10,2	5,8
Punëtorë shërbyes dhe punëtorë shitës në dyqane dhe tregje	23,5	22,6	23,3
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	3,0	1,9	2,8
Punëtorë zejtarie dhe të ngjashëm me ta	11,8	6,4	10,6
Operatorë fabrikash dhe makinerish dhe montues	7,2	0,6	5,7
Profesione elementare	23,8	11,7	21,1
<b>Gjithsej</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>

Burimi: Publikimi nga ASK "Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore 2019"

\* Pozitat elementare përfshijnë pastrues dhe ndihmës, punëtorë të bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit, punëtorë të minierave, ndërtimit, prodhimit industrial, transportit, asistentë të përgatitjes së ushqimit, punëtorë të shitjeve në rrugë, punëtorët e pastrimit të mbetjeve urbane dhe punëtorë të tjerë elementarë.



11

**INFRASTRUKTURA  
DHE ENERGJIA**

## INFRASTRUKTURA

Pozicioni gjeostrategjik i Kosovës në Ballkan dhe Evropë i jep Kosovës dhe infrastrukturës së saj rol me rëndësi pasi konsiderohet si portë lidhëse ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit.

Një nga projektet infrastrukturore më të mëdha ishte përfundimi i autostradës "Dr. Ibrahim Rugova" që ka lidhë Kosovën me Shqipërinë si dhe autostrada tjetër në drejtim të Maqedonisë së Veriut.

Përveç Infrastrukturës rrugore, Kosova qëndron mirë edhe me Infrastrukturë Hekurudhore, Ajrore, Energjetike, Telekomunikacion dhe Shërbime të Internetit.



Infrastruktura Rrugore – Territori i Kosovës ka një infrastrukturë të përshtatshme rrugore për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të biznesit. Rrjeti rrugor përbëhet nga 630 km rrugë kryesore. Me ndërtimin e autostradës me Shqipërinë, Kosova është një pikë e rëndësishme lidhëse e Evropës Perëndimore me Detin Adriatik, ndërsa autostrada për në Maqedoni të Veriut e lidhë Kosovën me pjesën lindore të Gadishullit Ballkanik dhe me Portin e Selanikut.

Infrastruktura hekurudhore – Kosova posedon një sistem hekurudhor prej 330 km që mbulon tërë territorin e Kosovës duke e lidhur veriun me jugun dhe lindjen me perëndimin.

Infrastruktura Ajrore – Kosova ka një aeroport të vetëm, aeroportin "Adem Jashari", i cili është një nga aeroportet më të ngarkuara në rajon. Ky aeroport ofron fluturime në qendrat më të rëndësishme evropiane, por edhe në Amerikë. Si transporti tjetër edhe transporti ajror përveç transportit të udhëtarëve bën edhe transportimin e mallrave të ndryshme (ngarkesave) për qëllime biznesi. Aeroporti i Prishtinës ofron një transferim të shpejtë, efektiv dhe profesional të ngarkesave. Aeroporti bën ekzaminimin e secilës ngarkesë përmes rrezeve X. Në varësi të peshës së ngarkesës gjithashtu tarifën e pagesave ndryshojnë.

Aeroporti i Prishtinës siguron kushte të përshtatshme për transportin e mallrave që kërkojnë trajtim të veçantë, duke zotëruar frigoriferë për ruajtjen e mallrave. Ai gjithashtu posedon të gjitha pajisjet për ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave.

Pas mbërritjes së mallrave, çdo kompani transporti duhet të bëjë tërheqjen brenda 24 orëve, përndryshe ata duhet të paguajnë tarifë shtesë.

Infrastruktura Energjetike – Sot, kapaciteti operativ i energjisë elektrike në Kosovë është rreth 900 MW, pothuajse të gjitha vijnë nga dy termocentrale të vjetra me thëngjill, Kosova A dhe Kosova B. Për të përmbushur

kërkesën në rritje për energji, për të zvogëluar ndërprerjet e energjisë, dhe emetimet e CO<sub>2</sub>. Qeveria e Kosovës po rehabiliton termocentralin e Kosovës B – e cila është më shumë se 30 vjeç – për ta sjellë atë në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, planifikohet ndërtimi i një termocentrali të ri, më efikas, me linjit për të zëvendësuar termocentralin 45 vjeçar me shumë ndotje Kosova A. Deri më tani, Kosova përdorë pak energji të rinovueshme vetëm 35 MW nga energjia me erë dhe 6 MW nga energjia diellore, të dyja vetëm në veprim që nga viti 2018. Me fillimin e punës së projektit të parkut të erës – SoWi Kosova, do të prodhoheshin edhe 105 MW. Gjithashtu, vlen të theksohet se fabrika "JAHA SOLAR" ishte kompania e parë në Kosovë që ka sjellur teknologjinë më të fundit në prodhimin e moduleve fotovoltaike.

Telekomunikacioni – Sektori i komunikimit elektronik ka rëndësi shumë të madhe ekonomike me vet faktin që në dhjetë vitet e fundit merr pjesë në GDP-në e Kosovës përrreth shifrës 10%.

Shërbimet telekomunikuese në dispozicion për qytetarët në Kosovë janë:

- Telefonia fikse nga ofruesit e telefonisë fikse, me qasje: lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Telefonia mobile nga ofruesit e telefonisë mobile, gjegjësisht Sistemi Global për komunikimet Mobile (ang. Global System for Mobile communications GSM) me qasje kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe shërbimin e roaming-ut
- Interneti përmes Ofruesve të Shërbimit të Internetit (ang. Internet Service Providers – ISP);
- Televizioni kabllor nga ofruesit e rrjetit kabllor televiziv.

12

**EKOSISTEMI  
I TË BËRIT BIZNES**



## FORMAT LIGJORE DHE LLOJET E BIZNESEVE

# 12

Llojet e biznesit:

1. Biznesi individual;
2. Ortakëri e përgjithshme;
3. Ortakëri e kufizuar;
4. Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara;
5. Shoqëri aksionare;
6. Shoqëria e Huaj Tregtare;
7. Zyra e Përfaqësisë së Shoqërisë së Huaj Tregtare;
8. Ndërmarrjet Shoqërore;
9. Ndërmarrjet Publike dhe
10. Kooperativat bujqësore.

### Hapja e kompanisë në Kosovë

Për ta regjistruar kompaninë tuaj në Kosovë duhet të drejtoheni tek Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), e cila operon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe gjendet në Rr. Arbënor e Astrit Dehari, Prishtinë. Orari i punës: E Hënë–e Premte ora 08:00:16:00 Kompaninë e regjistroni maksimum brenda dy ditëve të punës.

### Dokumentet e nevojshme:

1. Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Biznesit Individual (B.I.) ose Ortakëri e Përgjithshme (O.P.):
  1. Plotësimi formularit B,
  2. Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë),
  3. Pëlqimin e Përfaqësuesit të regjistruar në bazë të nenit 24.5 pika d) e Ligjit Nr. 06/L-016,
  4. Për Ortakëri të Përgjithshme marrëveshjen e ortakëve të përgjithshëm në bazë të nenit 31.1.3 të Ligjit Nr. 06/L-016.Afati për kryerjen e regjistrimit të Biznesit Individual dhe Ortakërisë së Përgjithshme në ARBK është 2 ditë.

### II. Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Ortakërisë së Kufizuar (O.K.)

1. Plotësimi i formularit AO,
2. Marrëveshja e shoqërisë në bazë të Nenit 32.13 të Ligjit Nr. 06/L-016,
3. Statuti,
4. Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë) kopje të pronarëve, përfaqësueseve të autorizuar të përfshirë në biznes,
5. Pëlqimin e Përfaqësuesit të regjistruar në bazë të nenit 24.5 të Ligjit Nr. 06/L-016,

### **III. Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K):**

1. Plotësimi i formularit AO, <https://arbk.rks-gov.net/Page.aspx?id=133>
2. Marrëveshja e shoqërisë në bazë të Nenit 82.1 të Ligjit Nr. 06/L-016,
3. Statuti në bazë të nenit 33 të Ligjit Nr. 06/L-016,
4. Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë) kopje të pronarëve, përfaqësueseve të autorizuar të përfshirë në biznes,
5. Pëlqimin e përfaqësuesit të regjistruar në bazë të nenit 24.5 të Ligjit Nr. 06/L-016. Afati për kryerjen e regjistrimit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqërive aksionare në ARBK është 3 ditë.

### **IV. Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Shoqërive Aksionare (SH.A):**

1. Plotësimi i formularit AO, <https://arbk.rks-gov.net/Page.aspx?id=133>
2. Statuti në bazë të Nenit 34.1.3 të Ligjit Nr. 06/L-016,
3. Marrëveshjen apo Rregulloren e Shoqërisë sipas Nenit 34.4 të Ligjit Nr. 06/L-016,
4. Pëlqimin e përfaqësuesit të regjistruar në bazë të nenit 24.5 të Ligjit Nr. 06/L-016,
5. Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë) kopje të pronarëve, përfaqësueseve të autorizuar të përfshirë në biznes.

### **V. Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Kompanisë së Huaj-Dega në Kosovë:**

1. Plotësimi i formularit AO, <https://arbk.rks-gov.net/Page.aspx?id=133>
2. Vendimi për hapjen e Kompanisë së huaj,
3. Vendimin për emërimin e Drejtorit (pasaporta kopje) dhe Përfaqësuesit të regjistruar (letërnjoftimi kopje),
4. Certifikata e biznesit (origjinal apo kopje e notorizuar, jo më e vjetër se tre muaj nga data e lëshimit dhe nëse nuk është në gjuhën shqipe, serbe apo angleze të përkthehet në njërin nga këto tri gjuhë dhe përkthimi të jetë i notorizuar) që e hap përfaqësinë në Kosovë,
5. Kopje e pasaportit të pronarit dhe drejtorit të Kompanisë së huaj,
6. Kopje e statutit të kompanisë së huaj,
7. Pëlqimin e Përfaqësuesit të Regjistruar në bazë të nenit 24.5 të Ligjit Nr. 06/L-016.

Vërejtje: Nëse pronari i biznesit nuk është prezent kur dorëzohen dokumentet atëherë aplikuesi mund t'i dorëzojë dokumentet me autorizim dhe letërnjoftim kopje.

## **VI. Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Kooperativës Bujqësore:**

1. Plotësimi i formularit KO, <https://arbk.rks-gov.net/Page.aspx?id=133>
2. Marrëveshja e Shoqërisë,
3. Statuti,
4. Vendimi për emërimin e drejtorit,
5. Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë) kopje të anëtarëve, personave të autorizuar të përfshirë në biznes,
6. Pëlqimin e Përfaqësuesit të regjistruar në bazë të nenit 24.5 të Ligjit Nr. 06/L-016.

## **VII. LEJET DHE LICENCAT**

Në këtë regjistër online mund t'i gjeni të gjitha lejet dhe licencat që ju duhen për të operuar në Kosovë. Lansimi i këtij regjistri qendror për leje dhe licenca mundëson rritjen e llogaridhënies karshi bizneseve dhe transparencën, duke lehtësuar kështu sistemin e punës së sektorit privat. <https://lejelicenca.rks-gov.net/sq/AllLicences>



13

**POLITIKAT  
FISKALE**

# PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE FISKALE

# 13

Politikat fiskale kryesore janë kundër-ciklike dhe janë zbatuar me qëllim të përkrahjes së rritjes ekonomike. Buxheti ka shënuar suficit para krizës financiare, të cilat kanë rritur rezervën e parasë së gatshme. Këto rezerva kanë ndihmuar në financimin e deficiteve të ulta fiskale – në mesataren prej 1.8 përqind e BPV-së – mes viteve 2008 dhe 2013, duke përkrahur rritjen ekonomike gjatë krizës. Borxhi i ulët publik – më pak se 20 përqind e BPV-së në fund të vitit 2019 – gjithashtu ka ofruar hapsirë për financimin e deficiteve fiskale.

Kosova ka zhvilluar një sistem fiskal të bazuar në përvojat dhe politikat më të mira të Bashkimit Evropian, në mënyrë që të ketë politika fiskale dhe legjislacion sa më të përafërt me atë të BE-së. Kjo vlen për tatimet dhe politikat doganore duke përfshirë tatimet direkte dhe indirekte (Tatimi në të Ardhurat e Korporatave, Tatimi në të Ardhurat Personale, Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Dogana, Akciza, etj )

Valuta Euro u shpall monedhë zyrtare e Kosovës nga data 1 Janar 2002. Kjo ishte ndërmarrë për të zëvendësuar përdorimin e mëparshëm të përhapur të markës gjermane, e cila kishte qenë monedhë matëse në vend përpara vitit 2002. Sot, euro është valuta më e përdorur në Kosovë.

## Llojet e tatimeve dhe normat tatimore

- Tatimi në të Ardhurat e Korporatave: 10%
- Tatimi mbi të Ardhurat Personale: 0 - 10 % (progresive)

Kontributi pensional  
i detyruar: 5%

**TATIMI NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE (TAK)** – Tatimi në të Ardhurat e Korporatave aplikohet në të ardhurat e tatueshme të korporatave. Tatimpaguesit me të ardhura bruto vjetore prej 50,000€ apo më pak, taten në masën 3% (për veprimtaritë siç është tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme komerciale) apo 9% (për veprimtaritë shërbyese, profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme). Tatimpaguesit me të ardhura bruto vjetore mbi 50,000€ taten me 10% në të ardhurat e tatueshme.

Norma tatimore: 10 %

**TATIMI NË TË ARDHURA PERSONALE (TAP)** – Tatimi në të Ardhurat Personale aplikohet në të gjitha të ardhurat që pranohet nga individ e që janë të tatueshme në bazë të Ligjit për Tatimin në të Ardhura Personale.

Tatimi në të Ardhura Personale aplikohet sipas shkallëve në vijim:

Norma tatimore	Të ardhurat mujore	Të ardhurat vjetore
0%	0 deri 80	0 deri 960
4%	80 deri 250	960 deri 3000
8%	250 deri 450	3000 deri 5400
10%	450 e tutje	5400 e tutje

**TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR**  
– Që nga shtatori i vitit 2015, TVSH është përshkallëzuar në dy norma, atë standarde prej tetëmbëdhjetë për qind (18%) dhe normën e reduktuar prej 8% te vlerës së furnizimeve të importuara dhe furnizimeve të brendshme të tatueshme, me përjashtim të furnizimeve të liruara dhe furnizimeve të trajtuara si eksporte.

Vendi	Tatimi mbi vlerën e shtuar	Tatimi mbi të ardhurat e korporatave
Shqipëria	20%	15%
Bosnja dhe Hercegovina	17%	10%
Kosova	18%	10%
Maqedonia	18%	10%
Mali i Zi	21%	9%
Serbia	20%	15%

Burimi: World Bank Doing Business Report 2020

**SHMANGIA E TATIMIT TË DYFISHTË** – Kosova për momentin ka Marrëveshje për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë me Austrinë, Belgjikën, Britaninë e Madhe, Emiratet e Bashkuara Arabe, Luksemburgun, Finlandën, Gjermaninë, Hungarinë, Kroacinë, Maltën, Maqedoninë e Veriut, Slloveninë, Shqipërinë, Turqinë dhe Zvicrën.

Marrëveshjet për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë me shumë shtete tjera janë në proces të bisedimeve.

**DETYRIMET DOGANORE** – Taksa doganore është 0% – 10%. Shumica e lëndëve të para janë

të liruara, shumica e pajisjeve për prodhimin janë të liruara, disa nga materialet e papërpunuara bujqësore (të tilla si farat, etj.) dhe pajisjet e tjera janë të liruara nga Dogana dhe TVSH-ja.

**AKCIZA** – Akcizat aplikohen në disa mallra vendore ose të importuara të tilla si: cigare, pije alkoolike, ujë dhe pije të tjera freskuese, naftë, etj.  
Kontakti në ATK/Adresa/Orari i punës: Departamenti për Regjistrim dhe Shërbim të Tatimpaguesve; e-mail: [info@atk-ks.org](mailto:info@atk-ks.org); tel: [038 200 250 17](tel:03820025017); [Sheshi "Nëna Terezë", Prishtinë; e Hëne – e Premte 08:00-16:00](#)



14

**SHËRBIMET  
BANKARE DHE  
FINANCIARE**



## SEKTORI BANKAR NË KOSOVË

# 14

Struktura e sistemit bankar dhe financiar në Kosovë përbëhet nga banka komerciale, degë të bankave të huaja, institucione mikrofinanciare, zyra të këmbimit valutor dhe agjencitë e transferimit të parave. Në Kosovë sot operojnë 10 banka komerciale dhe përbëjnë 69.0 përqind të aseteve totale të sektorit financiar. Produktet dhe shërbimet e tyre përfshijnë llogaritë bankare, kreditë, pagesa vendore dhe ndërkombëtare, kartela bankare, garancione bankare, letër kredi, e-banking.

Aktiviteti i tyre dominohet nga kreditë, afati i maturimit të të cilave mund të jetë deri në 15 vjet, varësisht nga lloji i kredisë. Nga totali i kredive, 65.2 përqind janë kredi për ndërmarrjet. Pjesa më e madhe e këtyre kredive absorbohet nga ndërmarrjet e sektorit të tregtisë (51.8 përqind e kredive të ndërmarrjeve), përderisa sektori i industrisë (përfshirë minierat, prodhimtarinë, energjinë



dhe ndërtimtarinë) ka 23.0 përqind të gjithsej kredive të ndërmarrjeve. Sektori i bujqësisë aktualisht përbën 4.0 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrje. Pjesëmarrja e kredive për ekonomitë familjare është 34.4 përqind të gjithsej kredive.

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, të cilat përfaqësojnë 80.2 përqind të gjithsej detyrimeve. Depozitat e sektorit bankar kanë shënuar rritje vjetore prej 6.5 përqind, duke arritur vlerën prej 2.7 miliardë Euro. Depozitat e sektorit bankar në Kosovë përbëhen nga depozitat e ekonomive familjare me një pjesëmarrje prej rreth 74.4 përqind të depozitave të gjithëmbarshme, përdërisa depozitat e ndërmarrjeve private përbëjnë 20.1 përqind. Bankat komerciale në Kosovë kanë strukturë të ndryshme aksionare. Tetë prej tyre janë banka me kapital të huaj dhe dy me kapital vendor. Numri i të punësuarve në bankat komerciale është rreth 3.337.

## Hapja e xhirollogarisë



Për hapje të llogarisë kërkohet:  
dokumenti identifikues (letërnjoftim  
ose pasaportë); një dëshmi mbi  
adresën/vendbanimin.

Kohëzgjatja:  
Max 2 ditë.

## Kontabiliteti

Big Four është pseudonimi që përdoret për t'iu referuar kolektivisht katër kompanive më të mëdha profesionale në botë, i përbërë nga Deloitte, Ernst & Young, KPMG dhe PricewaterhouseCoopers – që të gjitha janë prezente në Kosovë:

- Deloitte Kosovo  
kosova@deloittece.com;  
+383 38 760 300
- Pricewaterhouse Coopers Kosovo  
<https://www.pwc.com/ks/en.html>  
+383 38 722555
- Ernst and Young Kosovo  
[https://www.ey.com/en\\_al](https://www.ey.com/en_al)
- KPMG Albania Shpk Kosovo Branch  
Kosovo: Tel: +383 38 246 771

## Fondi Kosovar për Garanci Kreditore Përmirësimi i qasjes në financa dhe certifikimi i produkteve

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është themeluar në vitin 2016 dhe është institucion i pavarur dhe i qëndrueshëm që u lëshon garanci institucioneve financiare për të mbuluar rrezikun për kreditë e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të). Portofoli i përgjithshëm aktiv në vitin 2019 arriti në vëllimin prej 43.9 milion Euro i shpërndarë në 3,130 kredi aktive. Nga projekti për certifikimin e produkteve kosovare me standarde të cilësisë të njohura ndërkombëtarisht, i cili po implementohet nga BERZH në bashkëpunim me USAID dhe donatorët tjerë, kanë përfituar rreth 60 kompani kosovare.



15

**ZONAT INDUSTRIALE  
DHE PARQET E BIZNESIT**

## ZONAT INDUSTRIALE DHE PARQET E BIZNESIT

# 15

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në mandatin e saj ka zhvillimin e sektorit privat, duke përfshirë edhe sektorin për zhvillimin e zonave ekonomike. Zonat ekonomike në Kosovë janë të rregulluara me Ligjin për Zona Ekonomike, dhe përfshijnë: Parku i Biznesit në Drenas, Parku i Biznesit në Mitrovicë, Parku Teknologjik në Shtime, Parku Industrial në Frashër – Mitrovicë, Agro Zona Industriale në Suharekë, Parku Industrial në Lipjan si dhe dy (2) zona ekonomike Gjakovë dhe Prizren.

Çka ofrojnë parqet e bizneseve?

Parqet e bizneseve në Kosovë ofrojnë: parcela të gatshme për akomodim; qasje e lehtë dhe hapësirë për parkim; qasje në rryme, ujë, gaz, telefon, internet, ngohje. Nëse jeni të interesuar për hapësirat e lira në paqet e bizneseve, duhet ta kontaktoni KIESA.

### Përmbledhje rreth zonave të krijuara:

- ✓ Totali i hapësirave të zonave ekonomike të krijuara është rreth 170.20 ha.
- ✓ Numri i bizneseve / investitorëve të vendosura në zonat ekonomike është 80 biznese.
- ✓ Zhvilluesit e zonave ekonomike (komunat) janë në fazën e kontraktimit të bizneseve të tjera për t'u vendosur në zonat ekonomike deri në plotësimin e të gjitha kapaciteteve që kanë këto zona ekonomike.

Veprimtaritë që ushtrohet në hapësirat e zonave ekonomike janë nga me të ndryshmet, si: metalpunues, përpunim të plastikës, letrës, prodhime nga druri, prodhime farmaceutike, liftave (ashensorëve), përpunimin e pemëve dhe perimeve etj.

Numri i punëtoreve që janë duke punuar në bizneset që janë të vendosura në zonat ekonomike është rreth 600 – 700 punëtorë.

Dhënia e hapësirave në shfrytëzim, hapësirat në kuadër të zonave ekonomike jepen në shfrytëzim të bizneseve për një periudhë deri në 99 vite, si dhe me procedurë të lehtësuar si në nivel komunal dhe në atë qendror.

Përpos parqeve të biznesit, që janë në menaxhim të KIESA, në Kosovë gjendet edhe projekti më i madh gjermano-kosovar, ai i Parkut të Inovacionit dhe Trajnimeve ITP në Prizren, me 40 hektar hapësirë, dhe mbi 60 ndërtesa ekzistuese, duke përfshirë këtu hapësira për zyre, punishte, depo dhe një spital. ITP është shumë më tepër sesa një park klasik biznesi: Ka menaxhment gjerman, dhe synon të jetë qendra kryesore e inovacionit në Kosovë në fushën e TIK-ut, agro-ushqimit dhe industrive krijuese.

Mirëpo, investitorët potencialë kanë edhe mundësinë që të marrin në shfrytëzim toka, apo të blejnë prone private.

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bazohet në këto kritere:

- 1.1. prona e paluajtshme e komunës për dhënien në shfrytëzim të jetë e regjistruar në regjistrat kadastral të pronës;
- 1.2. qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme e komunës të jetë e harmonizuar me dokumentet e planifikimit hapësinor;
- 1.3. të ketë arsyeshmëri të interesit publik apo përfitimit ekonomik të komunës;
- 1.4. të plotësojë kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore.





16

**ANËTARËSIA  
NË ORGANIZATA  
NDËRKOMBËTARE**



# ANËTARËSIA NË ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE

Deri më tani, Republika e Kosovës është anëtarësuar në disa organizata ndërkombëtare ndërqeveritare dhe jo-qeveritare.

# 16

Organizata Ndërkombëtare	Statusi
Southeast European Cooperative Initiative (SECI)	Observer
South East Europe Transport Observatory (SEETO)	Member
Energy Community	Member
European Common Aviation Area (ECAA)	Member
Central European Free Trade Agreement (CEFTA)	Member
International Monetary Fund (IMF)	Member
World Bank	Member
European Bank for Reconstruction and Development (ERBD)	Member
Regional Cooperation Council (RCC)	Member
Council of Europe Development Bank (CEB)	Member
Council of Bureaux (CoBx)	Applicant

Adriatic Charter	Applicant
NATO Partnership for Peace (PfP)	Applicant
Council of Europe Venice Commission	Member
Organisation internationale de la Francophonie (OIF)	Member
South-East European Cooperation Process (SEECP)	Member
Egmont Group of Financial Intelligence Units	Member
World Customs Organization	Member
Permanent Court of Arbitration (PCA)	Member
European Qualifications Framework Advisory Group (EQF)	Member
International Criminal Police Organization (INTERPOL)	Applicant
International Federation of Arts Councils and Culture Agencies (IFACCA)	Member
Bureau of International Expositions (BIE)	Member
Apostille Convention	Signature/Yes
Stabilization and Association Agreement	Signature/Yes
Union of European Football Associations (UEFA)	Member
Fédération Internationale de Football Association (FIFA)	Member



17

**KONTAKTET  
ME RËNDËSI**

## INSTITUCIONE VENDORE

# 17

---

### Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

Adresa: Muharrem Fejza P.N., 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 38 200 36542, +383 (0) 38 200 36585  
E-Mail: [info.kiesa@rks-gov.net](mailto:info.kiesa@rks-gov.net)  
Website: <https://kiesa.rks-gov.net>

---

### Dogana e Kosovës

Adresa: P.O. Box 000, 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 38 540 350  
E-Mail: [info@dogana-rks.net](mailto:info@dogana-rks.net)  
Website: <https://dogana.rks-gov.net/en/>

---

### Administrata Tatimore e Kosovës

Adresa: Dëshmorët e Kombit dhe Bill Clinton P.N.,  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 38 200 250 25  
E-Mail: [info@atk-ks.org](mailto:info@atk-ks.org)  
Website: <http://www.atk-ks.org/?lang=en>

---

### Banka Qendrore e Kosovës

Adresa: Garibaldi Nr. 33, 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 38 222 055 107  
E-Mail: [info@bqk-kos.org](mailto:info@bqk-kos.org)  
Website: <https://www.bqk-kos.org/?m=t&id=1>

---

### Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës

Adresa: Muharrem Fejza P.N., 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 38 512 791  
E-Mail: [infoarb@rks-gov.net](mailto:infoarb@rks-gov.net)  
Website: <https://arb.rks-gov.net/page.aspx?id=2.1>

---

### **Agjencia e Pronësisë Industriale**

Adresa: Muharrem Fejza P.N., 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 200 36 582

Website: <https://kipa.rks-gov.net/>

---

### **Agjencia e Punësimit**

Adresa: Rr. Tirana, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 200 262 62

E-mail: [aprk.info@rks-gov.net](mailto:aprk.info@rks-gov.net)

Website: <https://aprk.rks-gov.net/>

---

### **Departamenti i Tregtisë**

Adresa: Arbënor e Astrit Dehari P.N.,  
10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 200 36 623

E-Mail: [tregtia@rks-gov.net](mailto:tregtia@rks-gov.net)

Website: <https://mti.rks-gov.net/>

---

### **Asociacionet e bizneseve në Kosovë**

#### **Oda Ekonomike e Kosovës**

Adresa: Nëna Tereze Nr.20, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 224 299

E-Mail: [info@oek-kcc.org](mailto:info@oek-kcc.org)

Website: <https://www.oek-kcc.org/En/>

---

#### **Oda Ekonomike Gjermano – Kosovare**

Adresa: Ali Hadri, P.N. Capital Gate, Kati 5,

12000 Fushë Kosovë, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 600 880

E-Mail: [info@oegjk.org](mailto:info@oegjk.org)

Website: <http://www.oegjk.org/oegjk/>

---

**Oda Ekonomike Amerikane  
në Kosovë**

Adresa: Str. Perandori Justinian, No. 132, Prishtinë 10000  
Tel: +381 38 609 012  
E-Mail: [info@amchamksv.org](mailto:info@amchamksv.org)  
Website: <https://www.amchamksv.org/>

---

**INSTITUCIONE  
NDËRKOMBËTARE  
NË KOSOVË**

**European Bank for Reconstruction  
and Development**

Adresa: Rruga Prishtine – Fushe Kosove,  
Lidhja e Pejës, Prishtinë 10060  
Tel: +381 38 24207000

---

**WORLD BANK**

Adresa: Ali Hadri, P.N. Capital Gate, Kati 3,  
12000 Fushë Kosovë, Kosovë  
Tel: +383-38-224-454-1100  
Email: [wbg-kosovo@worldbank.org](mailto:wbg-kosovo@worldbank.org)  
Website: <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo>

---

**The Deutsche Gesellschaft für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ)**

Adresa: Rr. Anton Çetta Nr. 1, 10000 Pristina  
Tel: +383 38 233 002 100  
E-mail: [giz-kosovo-buero@giz.de](mailto:giz-kosovo-buero@giz.de)  
Website: <https://www.giz.de/en/worldwide/298.html>

---

**KfW Office Pristina**

Adresa: Anton Çetta No.1 10000 Pristina  
Republic of Kosovo  
Tel: +383 38 224 141  
[kfw.pristina@kfw.de](mailto:kfw.pristina@kfw.de)

---

**USAID Kosovo**

Rr. 4 KORRIKU Nr. 25 Arberia 10 000 Pristina  
Tel: +383 38 5959 2000  
Email: [kosovousaidinfo@usaid.gov](mailto:kosovousaidinfo@usaid.gov)

---

## **AMBASADAT**

### **AMBASADA E REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË NË PRISTINË**

Adresa: Rr. Azem Jashanica Nr. 17 10 000 Prishtinë

Tel: +383 38 254500

---

### **AMBASADA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NË PRISHTINË**

Adresa: Rr. 4 KORRIKU Nr. 25 Arberia

10 000 Prishtinë

Tel: +383 38 59593000

---

### **AMBASADA E ZVICRËS**

Adresa: Adrian Krasniqi,

10 000 Prishtinë

Tel: +383 38 261261

---

### **AMBASADA AUSTRIAKE PRISHTINË**

Rruga Ahmet Krasniqi 94, Arbëria

10000 Prishtinë

Tel: (+383/38) 249 284

---

### **AMBASADA FRANCEZE**

Adresa: Rr. Ahmet Krasniqi Objekti C1-1, Nr.145,

10 000 Prishtinë

Tel: +383 38 70 33 11



Manuali  
për investitorët  
e huaj

---



Botues: Fondacioni-Konrad-Adenauer  
në Republikën e Kosovës

---

Autoret: Sytrime Dervisholli dhe Nora Hasani

---

Koordinimi: Zyra e KAS në Prishtinë

---

Printimi dhe Dizajni: Milky Way Creative

---

Fotografitë: Arben Llapashtica

---

Punimi mund të shkarkohet në:  
<http://www./kas.de/Kosovo>

Pikëpamjet e paraqitura në këtë manual janë pikëpamjet personale të autoreve dhe nuk paraqesin pikëpamjet e Fondacionit Konrad-Adenauer, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe/ose Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare.





Grand Hotel

Roiffeisen Bank



ProCredit Bank





# Manuali për investitorët e huaj

Sytrime Dervisholli  
Nora Hasani  
2020